

VENDIM
Nr. 419, datë 15.5.2013

PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË

(Ndryshuar me VKM Nr. 360, datë 11.6.2014; nr. 754, datë 12.11.2014)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 shkronjat “ç”, “d” e “e” dhe 7, pika 1 të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, të neneve 17 e 18 të ligjit nr. 10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e *Ministrit përgjegjës për ekonominë*, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, për vitin 2013, me vlerë prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh.

2. *Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë u jep ndihmë financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, deri në 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë, por në asnjë rast më shumë se 70% të kostove të pranueshme. Në kostot e pranueshme që mund të bashkëfinancohen, përfshihen kostot për:*

a) përshtatje produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të menaxhimit të cilësisë;

b) pjesëmarrje në panairë jashtë vendit;

c) krijim faqeje interneti, zhvillim të tregtisë elektronike dhe promovim, publikim dhe hartim materialesh promovuese;

d) shërbime këshillimore. Në këtë rast kostot që mund të bashkëfinancohen nuk mund të jenë më shumë se 50 % e kostos totale të këtyre shërbimeve.

3. Përfitojnë nga Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) prodhojnë produkte ose ofrojnë shërbime, që tregtohen apo që mund të tregtohen në nivel ndërkombëtar;

b) kanë një strategji dhe plan marketingu;

c) janë në gjendje të financojnë 100 për qind të gjitha kostot e projektit, të propozuara para përfundimit të tij.

4. *Pagesa e subvencionit të bëhet 50% me miratimin e projektit dhe 50% në fund të zbatimit të tij. Pagesa në fund të projektit do të bëhet kundrejt faturave të shpenzimeve të kryera për vlerën totale të projektit.*

5. *Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë zbatohet për periudhën tre vjeçare 2013, 2014 dhe 2015. Për vitin 2013 ai ka vlerën prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, për vitin 2014 vlera e fondit do të jetë 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekë dhe për vitin 2015 vlera do të jetë 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë.*

6. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë.

7. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, e cila miratohet nga *Ministri i përgjegjës për ekonominë*.

8. Efektet financiare¹, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i

¹ VKM nr. 754, datë 12.11.2014 botuar në F.Z nr. 180 datë 26/11/2014 në pikën 2 të saj shprehet: “2. Fondi prej 6 000 000 (gjashtë milionë) lekësh, që do të shtohet për vitin 2014, të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes/ AIDA-n, për vitin 2014.”

Ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

9. Vendimi nr. 112, datë 21.2.2007 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha